FLETORJA ZYRTARE
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare
www.legjislacionishqiptar.gov.al

Nr.17 23 shkurt 2007

P Ë R M B A J T J A

Faqe

Ligj nr.9681 datë 6.2.2007 — Për ratifikimin e "Marrëveshjes së huasë ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (IBRD) për projektin "Reforma për përmirësimin e mjedisit të biznesit dhe forcimin institucional""..... 303

Ligj nr.9682 datë 6.2.2007 — Për ratifikimin e "Marrëveshjes së financimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillim (IDA) për projektin "Reforma për përmirësimin e mjedisit të biznesit dhe fuqizimin institucional""..... 307

LIGJ
Nr.9681, datë 6.2.2007

PËR RATIFIKIMIN E "MARRËVESHJES SË HUASË NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE BANKËS NDËRKOMBËTARE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM (IBRD) PËR PROJEKTIN "REFORMA PËR PËRMIRËSIMIN E MJEDISIT TË BIZNESIT DHE FORCIMIN INSTITUCIONAL""

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet "Marrëveshja e huasë ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (IBRD) për projektin "Reforma për përmirësimin e mjedisit të biznesit dhe forcimin institucional"".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.5204, datë 19.2.2007 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

W-3372 LA
Departamenti ligjor
Kirsi Propst
Teksti i negociuar i rishikuar–6 shtator 2006
Numri i huasë _____ ALB

MARRËVESHJE HUAJE

(Projekti për Reformën në Mjedisin e Biznesit dhe Fuqizimin Institucional) ndërmjet Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim datë _____2006

Marrëveshja e datës____2006 ndërmjet Shqipërisë (Huamarrësi) dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (Banka). Huamarrësi dhe Banka bien dakord si më poshtë vijon:

Meqenëse Huamarrësi ka kërkuar, gjithashtu, që Shoqata t'i sigurojë ndihmë shtesë për financimin e projektit dhe sipas një marrëveshjeje të së njëjtës datë si këtu, e nënshkruar ndërmjet Huamarrësit dhe Shoqatës (Marrëveshje financimi), Shoqata bie dakord ta japë këtë ndihmë me një shumë totale fillestare të barabartë me dy milionë e pesëqind mijë të drejta speciale tërheqjeje (2.500.000 SDR) (Kredia).

Neni 1
Kushte të përgjithshme, përkufizime

1.01 Kushtet e përgjithshme (siç janë përcaktuar në shtojcën e kësaj Marrëveshjeje) janë pjesë

përbërëse e kësaj Marrëveshjeje.

1.02 Nëse konteksti nuk e kërkon ndryshe, termat me germa kapitale dhe të përdorura në Marrëveshjen e huasë do të kenë kuptimin që u është dhënë atyre në kushtet e përgjithshme në Marrëveshjen e financimit ose në shtojcën e kësaj Marrëveshjeje.

Neni 2
Huaja

2.01 Banka bie dakord që t'i japë hua Huamarrësit, sipas termave dhe kushteve të përcaktuara ose të referuara në këtë Marrëveshje, një shumë prej katër milionë e katërqind mijë euro (4.400.000 €) për të ndihmuar në financimin e projektit të përshkruar në planin kohor 1 të Marrëveshjes së financimit (Projektit).

2.02 Huamarrësi mund të tërheqë të ardhurat e huasë në përputhje me planin kohor 1 të kësaj Marrëveshjeje.

2.03 Tarifa e detyrimit financiar që duhet të paguajë Huamarrësi do të jetë e barabartë me tre të katërtat e njëpërqindëshi (3/4 e 1%) në vit, e llogaritur mbi bilancin e huasë së patërhequr, i cili i nënshtrohet çdo heqjeje të një pjese të këtij komisioni, siç mund të përcaktohet nga Banka herë pas here.

2.04 Tarifa fillestare që duhet të paguajë Huamarrësi do të jetë e barabartë me një për qind (1%) të shumës së huasë, e cila i nënshtrohet çdo heqjeje të një pjese të kësaj tarife, siç mund të përcaktohet nga Banka herë pas here.

2.05 Interesi që duhet të paguajë Huamarrësi për çdo periudhë interesi do të jetë në përqindjen e LIBORI-it për monedhën në të cilën është huaja plus shpërndarjen variabël, i cili i nënshtrohet çdo heqjeje të një pjese të këtij interesi, siç mund të përcaktohet nga Banka herë pas here.

2.06 Datat e pagesave janë 15 maj dhe 15 nëntor të çdo viti.

2.07 Shuma e principalit të huasë do të ripaguhet në përputhje me planin kohor të amortizimit, të parashtruar në planin kohor 2 të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 3
Projekti

3.03 Huamarrësi deklaron angazhimin e tij ndaj objektivave të projektit. Për këtë qëllim, Huamarrësi, nëpërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, do të zbatojë projektin në përputhje me dispozitat e nenit 5 të kushteve të përgjithshme.

3.04 (a) Në bazë të paragrafit (b) të këtij seksioni, seksionit 3.02 të Marrëveshjes së financimit dhe planeve kohore 1 dhe 2 të saj, me përjashtim të seksionit V të planit kohor 2, janë të përfshira në Marrëveshjen e huasë, me modifikimet e mëposhtme në këtë seksion dhe planet kohore, nëse konteksti nuk e kërkon ndryshe:

i) termi "Shoqatë" do të lexohet "Bankë";

ii) termi "Marrës" do të lexohet "Huamarrës";

iii) termi "Kredi" do të lexohet "Hua"; dhe

iv) termat "kjo Marrëveshje" ose "Marrëveshja e financimit" do të lexohet "Marrëveshja e huasë".

b) Nëse ndonjë pjesë e kredisë e parashikuar në këtë Marrëveshje financimi mbetet e padhënë dhe nëse Huamarrësi nuk ka marrë ndonjë njoftim tjetër nga Banka:

i) të gjitha veprimet e ndërmarra, duke përfshirë edhe miratimet e dhëna nga Shoqata në përputhje me çdo seksion dhe planet kohore të Marrëveshjes së financimit, të parashikuara në paragrafin (a) të këtij seksioni, si dhe në pajtim me seksionin 2.02 të Marrëveshjes së financimit, do të konsiderohen të kryera në emër të dhe për llogari të të dyjave, Shoqatës dhe Bankës; dhe

ii) i gjithë informacioni dhe dokumentacioni i dorëzuar nga Huamarrësi te Shoqata, në pajtim me dispozitat e një prej seksioneve të Marrëveshjes së financimit ose planeve kohore të saj, do të konsiderohen si të dorëzuara te të dyja, te Shoqata dhe te Banka.

Neni 4
Zgjidhjet ligjore të Bankës

4.01 Shkaku shtesë i pezullimit konsiston në një nga faktet e mëposhtme, pikërisht kur një ligj, i cili krijon një nga subjektet përfituese të projektit, amendohet, pezullohet, abrogohet, shfuqizohet apo anulohet, në mënyrë të tillë që sipas mendimit të Bankës mund të ndikojë materialisht dhe negativisht në aftësinë e subjektit përkatës përfitues nga projekti, për të përmbushur në mënyrë efektive detyrimet e tij sipas kësaj Marrëveshjeje.

4.02 Shkaqet shtesë të përshpejtimit konsistojnë në rastin e mëposhtëm të parashikuar në seksionin 4.01 të kësaj Marrëveshjeje, që ndodh dhe vazhdon për një periudhë prej gjashtëdhjetë (60) ditësh pasi Banka t'i ketë dhënë njoftimin për këtë rast Huamarrësit.

Neni 5
Hyrja në fuqi, mbarimi

5.01 Kushti shtesë i hyrjes në fuqi konsiston në faktin që Marrëveshja e financimit është ekzekutuar dhe dërguar dhe janë përmbushur të gjitha kushtet para hyrjes së saj në fuqi, me përjashtim të atyre që lidhen me hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.

5.02 Afati i hyrjes në fuqi është dita e nëntëdhjetë (90) pas datës së kësaj Marrëveshjeje.

Neni 6
Përfaqësimi, adresat

6.01 Përfaqësuesi i Huamarrësit është Ministri i Financave.

6.02 Adresa e Huamarrësit:
Ministria e Financave
Bulevardi: "Dëshmorët e Kombit"
Tirana, Albania
Faks:
+3554228494

6.03 Adresa e Bankës:
International Bank for Reconstruction and Development (Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim)
1818 H Street, N.W.
Washington, D.C. 20433
United States of America

Adresa me telegram:	Teleks:	Faks:
INTBAFRAD	248423(MCI) ose	1-202-477-6391
Washington, D.C.	64145(MCI)	

- Rënë dakord (nënshkruar) në_____,_____,në datën dhe vitin e më sipërm.

PLANI KOHOR 1
TËRHEQJA E TË ARDHURAVE NGA HUAJA

A. Të përgjithshme

1. Huamarrësi mund të tërheqë të ardhurat nga huaja në përputhje me dispozitat e këtij seksioni dhe udhëzimet e tjera shtesë, të cilat do t'i specifikojë Banka, duke e lajmëruar Huamarrësin në lidhje me shpenzimet e përshtatshme, siç janë përshkruar në tabelën e paragrafit 2 më poshtë.

2. Tabela e mëposhtme specifikon kategoritë e shpenzimeve të përshtatshme, të cilat mund të financohen nga të ardhurat e huasë (Kategoria), alokimin e shumave të huasë për secilën kategori, si dhe përqindjen e shpenzimeve që do të financohen si shpenzime të përshtatshme në secilën kategori.

Kategoria	Shuma e kredisë së alokuar (e shprehur në euro)	Përqindja e Shpenzimeve që duhen financuar
1. Mallra	1.650.000	95%
2. Punime	2.690.000	95%
3. Shërbime konsulence	10.000	95%
4. Të paalokuara	50.000	
5. Tarifa fillestare	0	Shumë e cila duhet paguar në bazë të seksionit 2.04 të kësaj Marrëveshjeje, në pajtim me seksionin 2.07(b) të kushteve të përgjithshme
Shuma totale	4.400.000	

B. Kushtet e tërheqjes, periudha e tërheqjes

1. Pavarësisht nga dispozitat e pjesës A të këtij seksioni, nga llogaria e huasë nuk do të bëhet asnjë tërheqje për pagesa të bëra para datës së kësaj Marrëveshjeje.

2. Data e përfundimit është 15 janar 2011.

PLANI KOHOR 2
PLANI KOHOR I AMORTIZIMIT

Data e pagesës së principalit	Principali i huasë që duhet paguar (i shprehur në euro)
15 maj 2011	135,000
15 nëntor 2011	140,000
15 maj 2012	140,000
15 nëntor 2012	145,000
15 maj 2013	145,000
15 nëntor 2013	150,000
15 maj 2014	150,000
15 nëntor 2014	155,000
15 maj 2015	155,000
15 nëntor 2015	160,000
15 maj 2016	160.000
15 nëntor 2016	165.000
15 maj 2017	165.000
15 nëntor 2017	170.000
15 maj 2018	170.000
15 nëntor 2018	175.000
15 maj 2019	180.000
15 nëntor 2019	180.000
15 maj 2020	185.000
15 nëntor 2020	190.000
15 maj 2021	190.000
15 nëntor 2021	195.000
15 maj 2022	200.000
15 nëntor 2022	200.000
15 maj 2023	205.000
15 nëntor 2023	195.000

SHTOJCË
PËRKUFIZIME

1. “Kategoria” nënkupton një kategori të përcaktuar në tabelën e planit kohor 1 të kësaj Marrëveshjeje.

2. “Marrëveshje financimi” nënkupton marrëveshjen ndërmjet Huamarrësit dhe Shoqatës për projektin që mban të njëjtën datë, si dhe Marrëveshja e huasë, dhe kjo Marrëveshje mund të amendohet herë pas here. "Marrëveshja e financimit" përfshin të gjitha shtojcat, planet kohore dhe marrëveshjet që i shtohen Marrëveshjes së financimit.

3. “Kushtet e përgjithshme” nënkuptojnë "Kushtet e përgjithshme për huatë e Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim" të datës 1 korrik 2005.

LIGJ
Nr.9682, datë 6.2.2007

PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES SË FINANCIMIT NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE SHOQATËS NDËRKOMBËTARE PËR ZHVILLIM (IDA) PËR PROJEKTIN “REFORMA PËR PËRMIRËSIMIN E MJEDISIT TË BIZNESIT DHE FUQIZIMIN INSTITUCIONAL””

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja e financimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillim (IDA) për projektin “Reforma për përmirësimin e mjedisit të biznesit dhe fuqizimin institucional””.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.5205, datë 19.2.2007 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

W-3372 LA
Departamenti ligjor
Kirsi Propst
Teksti i negociuar, i rishikuar–6 shtator 2006
Numri i kredisë _____ ALB

MARRËVESHJE FINANCIMI

(Projekti për reformën në mjedisin e biznesit dhe fuqizimin institucional) ndërmjet Shqipërisë dhe Shoqatës për Zhvillim Ndërkombëtar datë _____ 2006

Marrëveshje e nënshkruar në datën ___ 2006, ndërmjet Shqipërisë (Përfituesi) dhe

Organizatës Ndërkombëtare për Zhvillim (Shoqata). Përfituesi dhe Shoqata bien dakord për sa më poshtë vijon:

Meqenëse Përfituesi i ka kërkuar gjithashtu Bankës dhënien e ndihmës shtesë për financimin e projektit dhe sipas një marrëveshjeje të së njëjtës datë si këtu më poshtë, e nënshkruar ndërmjet Përfituesit dhe Bankës (Marrëveshje huaje), Banka bie dakord ta japë këtë ndihme me një shumë totale principale të barabartë me katër milionë e katërqind mijë euro (4,400,000 €) (Huaja).

Neni 1
Kushte të përgjithshme, përkufizime

1.01 Kushtet e përgjithshme (siç është përcaktuar edhe në shtojcën e kësaj Marrëveshjeje) janë pjesë përbërëse e kësaj Marrëveshjeje.

1.02 Nëse konteksti nuk e kërkon ndryshe, termat me germa kapitale të përdorura në Marrëveshjen e financimit do të kenë kuptimet që u janë dhënë në kushtet e përgjithshme ose në shtojcën e kësaj Marrëveshjeje.

Neni 2
Financimi

2.01 Shoqata bie dakord t'i japë Përfituesit, sipas termave dhe kushteve të përcaktuara ose të cilave u referohet kjo Marrëveshje, një kredi në një shumë të barabartë me dy milionë e pesëqind mijë të drejta speciale tërheqjeje (SDR 2,500,000) (Kredia), për të ndihmuar në financimin e projektit të përshkruar në planin kohor 1 të kësaj Marrëveshjeje (Projekti).

2.02 Përfituesi mund t'i tërheqë të ardhurat nga kredia në përputhje me seksionin V të planit kohor 2 të kësaj Marrëveshjeje.

2.03 Shuma maksimale e detyrimit financiar që Përfituesi duhet të paguajë mbi bilancin e kredisë së patërhequr do të jetë sa gjysma e njëpërqindëshit (1/2 e 1%) në vit.

2.04 Tarifa e shërbimit që duhet të paguajë Përfituesi mbi bilancin e kredisë së tërhequr do të jetë tri të katërtat e njëpërqindëshit (3/4 e 1%) në vit.

2.05 Datat e pagesave janë 15 maj dhe 15 nëntor në çdo vit.

2.06 Shuma principale e kredisë do të ripaguhet në pajtim me planin kohor të ripagesave, të përshkruar në planin kohor 3 të kësaj Marrëveshjeje.

2.07 Monedha e pagesës është euro.

Neni 3
Projekti

3.01 Përfituesi deklaron angazhimin e tij ndaj objektivave të projektit. Për këtë qëllim, Përfituesi, nëpërmjet Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, do të zbatojë projektin në përputhje me dispozitat e nenit 4 të kushteve të përgjithshme.

3.02 Pa u kufizuar në dispozitat e seksionit 3.01 të kësaj Marrëveshjeje dhe përveç rasteve kur Përfituesi dhe Organizata kanë rënë dakord ndryshe, Përfituesi do të sigurojë që projekti të zbatohet në pajtim me dispozitat e planit kohor 2 të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 4
Zgjidhjet ligjore të Shoqatës

4.01 Shkaku shtesë i pezullimit konsiston në faktin e mëposhtëm, kryesisht kur amendohet, pezullohet, anulohet apo shfuqizohet një ligj që krijon një nga subjektet e Përfituesit të projektit, në mënyrë të tillë që sipas mendimit të Bankës mund të ndikojë materialisht dhe negativisht në mundësinë e subjektit përkatës të Përfituesit të projektit për të përmbushur në mënyrë efektive detyrimet e tij të përcaktuara në këtë Marrëveshje.

4.02 Shkaqet shtesë të përshpejtimit konsistojnë në faktin e mëposhtëm, kryesisht kur shkaku i

specifikuar në seksionin 4.01 të kësaj Marrëveshjeje ndodh dhe vazhdon për një periudhë prej gjashtëdhjetë (60) ditësh, pasi Shoqata t'i ketë dhënë Përfituesit njoftimin për këtë rast.

Neni 5
Hyrja në fuqi, mbarimi

5.01 Kushti shtesë i hyrjes në fuqi konsiston në faktin e mëposhtëm, kryesisht kur Marrëveshja e huasë është ekzekutuar dhe dërguar, dhe janë përmbushur të gjitha kushtet paraprake për hyrjen e saj në fuqi, me përjashtim të atyre që lidhen me hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.

5.02 Afati i hyrjes në fuqi është dita e nëntëdhjetë (90) pas nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 6
Përfaqësimi, adresat

6.01 Përfaqësuesi i Përfituesit është Ministri i Financave.
6.02 Adresa e Përfituesit:
Ministria e Financave
Bulevardi: "Dëshmorët e Kombit"
Tirana, Shqipëri
Faks:
+355 42 28494
6.03 Adresa e Shoqatës:
International Development Association (Organizata Ndërkombëtare për Zhvillim)
1818 H Street, N.W.
Washington, D.C. 20433
United States of America

Telegram:	Teleks:	Faks:
INDEVAS	248423 (MCI) or	1-202-477-6391
Washington, D.C.	64145 (MCI)	

Rënë dakord (nënshkruar) në _____, _____, në datën dhe vitin e mësipërm.

PLANI KOHOR 1
PËRSHKRIMI I PROJEKTIT

Objektivat e projektit janë: (a) lehtësimi i hyrjes dhe operimit në biznes; si dhe (b) fuqizimi i kapacitetit të sektorit të biznesit të Përfituesit, rritja e eksporteve drejt tregjeve rajonale dhe ato të Bashkimit Europian (BE).

Projekti përbëhet nga pjesët që vijojnë, të cilat u nënshtrohen ndryshimeve, me marrëveshje të herëpashershme të Përfituesit dhe Shoqatës, në mënyrë që të arrihet plotësimi i objektivave të vendosura:

Pjesa A) Lehtësimi i hyrjes dhe operacioneve në biznes

1. Dhënia e asistencës teknike, mallrave dhe trajnimeve për zhvillimin institucional dhe ngritjen e kapaciteteve për të përmirësuar në mënyrë sistematike cilësinë e rregullave që ndikojnë në krijimin dhe aktivitetin e bizneseve nëpërmjet: (a) ngritjes së kapaciteteve rregullatore dhe një sistemi menaxhimi rregullator në nivelin e ministrive të linjës dhe atë të pushtetit qendror; (b) zhvillimit të kapaciteteve për përmirësimin e cilësisë së rregullave të reja dhe ekzistuese, nëpërmjet analizave të ndikimit dhe metodave plotësuese; (c) përmirësimit të cilësisë së rregullave ekzistuese nëpërmjet vlerësimeve të rregulloreve të synuara në zonat e përzgjedhura dhe zgjerimit të mundësisë për këto rregulla; (d) zhvillimit dhe zbatimit të një sistemi monitorimi dhe vlerësimi për reformat rregullatore; si dhe (e) ndërmarrjes së vëzhgimeve mbi bizneset e vogla dhe dy ARCS-të për të vlerësuar përfundimet e pjesës A të projektit.

2. Dhënia e asistencës teknike, trajnimeve për fuqizimin e kapaciteteve të Njësisë së Politikave të Konkurrencës (NPK) për vlerësimin e ndikimit të rregullave mbi konkurrencën në treg.

Pjesa B) Zhvillimi dhe fuqizimi i sistemit të MSTQ-së

Sigurimi i punimeve civile, ndihmës teknike, trajnimeve dhe mallrave për zhvillimin institucional dhe ngritjen e kapaciteteve të sistemit MSTQ-së të Përfituesit, në mënyrë që të ofrojë shërbime të standardeve të Bashkimit Europian nëpërmjet:

1. përgatitjes dhe zbatimit të një strategjie të plotë afatmesme, që do të sigurojë përshtatjen e institucioneve të MSTQ-së me kërkesat dhe praktikat e Bashkimit Europian dhe nevojat e industrisë;

2. organizimit dhe kryerjes së fushatave publike ndërgjegjësuese, në mënyrë që të rritet ndërgjegjësimi brenda komunitetit të biznesit të Përfituesit dhe institucioneve qeveritare në lidhje me shërbimet dhe përmbushjen e standardeve të MSQT-së;

3. zgjerimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë dhe Kalibrimit (DPMK), duke përfshirë modernizimin e infrastrukturës kombëtare të metrologjisë, hartimin dhe ndërtimin e një ndërtese moderne metrologjie dhe sigurimin e mallrave/materialeve, asistencës teknike dhe trajnimeve;

4. ngritjes së kapaciteteve brenda Drejtorisë së Përgjithshme të Standardizimit (DPS) për krijimin dhe menaxhimin e standardeve MSTQ-së të BE-së dhe ofrimit të tyre në mënyrë elektronike për përdoruesit;

5. zhvillimit të kapaciteteve brenda Drejtorisë së Akreditimit (DA) për kryerjen e vlerësimeve të MSTQ-së dhe të trajnimeve të ekspertëve për kryerjen e këtyre vlerësimeve.

Pjesa C) Mbështetje për koordinimin e projektit

Sigurimi i asistencës teknike, trajnimeve, mallrave dhe shpenzimeve operative shtesë për zhvillimin institucional dhe ngritjen e kapaciteteve të Departamentit të Politikave të Tregut (DPT), duke përfshirë mbështetjen për:

1. zbatimin e aktiviteteve të parashikuara në këtë projekt;

2. hartimin dhe zbatimin e sistemit të monitorimit dhe vlerësimit të projektit;

3. fushata informacioni për ndërgjegjësimin e publikut dhe aktivitete për shpërndarjen e informacionit;

4. aktivitete që lidhen me menaxhimin financiar, disbursimin dhe prokurimin.

PLANI KOHOR 2
ZBATIMI I PROJEKTIT

Pjesa I. Rregullimet institucionale

Përfituesi do të zbatojë projektin në përputhje me mekanizmat koordinues të mëposhtëm:

1. DMP-ja brenda METE-s do të jetë përgjegjëse për koordinimin dhe menaxhimin e përditshëm të projektit. Ndërmjet të tjerash, DMP-ja: (a) do të jetë përgjegjëse për planifikimin e projektit, buxhetimin, menaxhimin financiar, pagesat, prokurimet, revizionimin dhe monitorimin, vlerësimin e ecurisë dhe rezultateve të projektit; (b) do të funksionojë si lidhje midis enteve përfituese të projektit dhe Shoqatës dhe do të asistojë këto ente në zbatimin e aktiviteteve të projektit, në përputhje me objektivat e projektit; (c) do të ndihmojë/asistojë në organizimin e fushatave ndërgjegjësuese publike dhe studime periodike biznesi, si p.sh. ARCS-ja; (d) do të ndihmojë në organizimin e konsultimeve me komunitetin e biznesit të përfituesit, në mënyrë që të arrihet një pjesëmarrje sa më e madhe e komunitetit të biznesit në reformat e sektorit privat; dhe (e) do të sigurojë dhe/ose vërë në lëvizje një mbështetje për prokurim, menaxhim financiar dhe monitorimin, vlerësimin shtesë, nëse shihet e nevojshme; (f) do të organizojë aktivitete propagandimi lidhur me progresin e përfituesve në zbatimin e axhendës së reformës së mjedisit të biznesit; (g) do të zbatojë dhe do të asistojë, duke monitoruar aktivitetet e përshkruara në pjesën A. 1 të projektit dhe (h) do të koordinojë asistencën/mbështetjen për përgatitjen dhe zbatimin e strategjisë për zhvillimin e integruar të sistemit të MSTQ-së dhe për privatizimin e më pas akreditimin e laboratorëve të metrologjisë së rretheve dhe komunave.

2. Entet e Përfituesit të projektit do të jenë përgjegjëse për zbatimin e aktiviteteve specifike të projektit dhe do të ndihmojnë DMP me monitorimin e rezultateve që lidhen me këto aktivitete të projektit. Si të tilla: (a) CPU do të jetë përgjegjëse për zbatimin dhe do të ndihmojë me monitorimin e aktiviteteve të përshkruara në pjesën A 2 të projektit; (b) DPMK, DPS dhe DA do të jenë përgjegjëse për zbatimin dhe do të ndihmojnë në monitorimin e aktiviteteve të përshkruara në pjesën B të projektit. Entet e Përfituesit të projektit, gjithashtu, do të ndihmojnë DMP-në me prokurimin nëpërmjet përgatitjes së specifikimeve teknike, termave të referencës dhe aktivitete të tjera të lidhura

me prokurimet.

3. Përfituesi do të sigurojë që gjatë gjithë kohës së zbatimit të projektit, DMP dhe entet e Përfituesit të projektit do të jenë funksionale, të pajisura me stafin e nevojshëm, të financuara dhe të mirëmbajtura mbi bazën e termave të referencës të pranueshme për Shoqatën.

4. DMP-ja është përgjegjëse për monitorimin dhe vlerësimin e ecurisë së Përfituesit në zhvillimin dhe zbatimin e reformave në mjedisin e biznesit të mbështetur nga projekti, duke përfshirë një vlerësim për rezultatin e aktiviteteve në lidhje me ndërtimin e kapaciteteve sipas projektit. Si i tillë, Përfituesi, nëpërmjet DMP-së, deri më 31 mars 2007, do t'i paraqesë Shoqatës për rishikim dhe komente një plan vjetor pune dhe buxhet për projektin mbi pjesën e mbetur të vitit kalendarik 2007, dhe më 30 shtator të çdo viti, duke filluar nga 30 shtatori 2007, do t'i paraqesë Shoqatës një raport vjetor të planit të punës dhe buxhet për projektin për vitin e ardhshëm kalendarik dhe do t'i paraqesë Shoqatës një raport ecurie më 31 janar dhe 31 korrik të çdo viti, duke filluar nga data 31 korrik 2007.

Pjesa II. Marrëveshjet e zbatimit

1. Përfituesi do të përmbushë detyrimet në përputhje me planin e menaxhimit mjedisor dhe nuk do të amendojë, pezullojë, shfuqizojë, anulojë apo heqë ndonjë dispozitë ligjore të planit të menaxhimit mjedisor, pa pasur më parë miratimin e Shoqatës.

2. Përfituesi, nëpërmjet METE-s:

a) jo më vonë se 31 mars 2007, do të përgatisë dhe miratojë një strategji të plotë afatmesme për zhvillimin e integruar të sistemit të MSTQ-së të Përfituesit, në mënyrë që të jetë i pranueshëm për Shoqatën, dhe më pas ta zbatojë atë në mënyrë sa më të pranueshme për Organizatën;

b) do të fillojë fushata të integruara publiciteti në lidhje me komponentët e MSQT-së për projektin, jo më vonë se 31 dhjetori 2007; si dhe

c) do të fillojë ARCS-në e parë jo më vonë se 31 marsi 2008 dhe do të fillojë ARCS-në e dytë jo më vonë se 31 marsi 2010, duke kontraktuar një kompani të pavarur private vëzhgimesh ose sondazhesh, që të jetë e pranueshme për Shoqatën dhe sipas termave të referencës të pranueshme për Shoqatën.

3. Përfituesi do të bëjë të mundur që GDOMC-ja, jo më vonë se 31 mars 2007, të përgatisë dhe miratojë një strategji kombëtare metrologjie, duke përshirë një plan veprimi për konsolidimin e laboratorëve rajonalë dhe komunalë të metrologjisë, të pranueshëm për Shoqatën, dhe më pas t'i zbatojë dhe mirëmbajë ato në mënyrë sa më të pranueshme për Shoqatën.

Pjesa III. Monitorimi, raportimi, vlerësimi i projektit

A) Raportet e projektit

1. Përfituesi do të monitorojë dhe vlerësojë ecurinë e projektit dhe do të përgatisë raportet e projektit në përputhje me parashikimet e seksionit 4.08 të kushteve të përgjithshme dhe mbi bazën e treguesve të rënë dakord me Shoqatën. Çdo raport projekti do të mbulojë periudhën e një semestri kalendarik dhe do t'i dorëzohet Shoqatës jo më vonë se një muaj pas mbarimit të periudhës së mbuluar nga ky raport.

2. Pa u kufizuar nga parashikimet e paragrafit 1 të këtij nënseksioni, Përfituesi:

a) do të përgatisë, sipas termave të referencës të pranueshme për Shoqatën, dhe do t'i dorëzojë Shoqatës në datën ose rreth datës 31 tetor 2008 një raport përmbledhës të rezultateve të monitorimit dhe vlerësimit të aktiviteteve të kryera në përputhje me paragrafin (1) të këtij seksioni, të progresit të arritur në zbatimin e projektit gjatë periudhës përpara datës së raportit të përmendur dhe vendosjes së masave të rekomanduara për të siguruar zbatimin efikas të projektit dhe arritjen e objektivave të vendosura për periudhën që do të vijojë pas kësaj date; si dhe

b) do të rishikojë, së bashku me Shoqatën, deri në datën 30 nëntor 2008 ose deri në një datë të mëvonshme që do ta vendosë Shoqata, raportin e përmendur në paragrafin (a) të kësaj pjese dhe më pas do të marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar përfundimin me efikasitet të projektit dhe arritjen e objektivave të vendosura për të, mbi bazën e konkluzioneve dhe rekomandimeve të raportit në fjalë dhe pikëpamjeve të Shoqatës mbi këtë çështje.

B) Menaxhimi financiar, raportet financiare dhe auditimet

1. Përfituesi do të mbajë ose rregullon mbajtjen e një sistemi menaxhimi financiar, në përputhje me parashikimet e seksionit 4.09 të kushteve të përgjithshme.

2. Pa u kufizuar në dispozitat e pjesës A të këtij seksioni, Përfituesi do të përgatisë dhe do t'i dorëzojë Shoqatës, jo më vonë se 45 ditë pas mbarimit të çdo tremujori kalendarik, raportet progresive financiare të paaudituara për periudhën tremujore të projektit, në formë dhe përmbajtje të

pranueshme për Shoqatën.

3. Përfituesit do t'i auditohen raportet e tij financiare në përputhje me dispozitat e seksionit 4.09 (b) të kushteve të përgjithshme. Çdo auditim i deklaratave financiare do të mbulojë periudhën e një viti fiskal të Përfituesit, duke filluar me vitin fiskal në të cilin është bërë tërheqja e parë në këtë projekt. Deklaratat financiare të audituara për secilën periudhë do t'i dorëzohen Shoqatës jo më vonë se gjashtë (6) muaj pasi kjo periudhë të ketë mbaruar.

Pjesa IV. Prokurimi

A) Të përgjithshme

1. Mallra dhe punime. Të gjitha mallrat dhe punimet e nevojshme për projektin dhe që do të financohen nga të ardhurat e kredisë do të prokurohen në përputhje me kërkesat e parashtruara ose të përmendura në seksionin 1 të udhëzimeve për prokurimet, si dhe me dispozitat e këtij plani kohor.

2. Shërbime konsulence. Të gjitha shërbimet e konsulencës së nevojshme për projektin dhe që do të financohen nga të ardhurat e kredisë, do të prokurohen në përputhje me kërkesat e parashtruara ose të përmendura në seksionin I dhe IV të udhëzimeve për konsulencën, si dhe me dispozitat e këtij plani kohor.

3. Përkufizime. Termat me germa kapitale të përdorura më poshtë në këtë seksion, të cilat përshkruajnë metodat specifike të prokurimit ose metodat e rishikimit të Shoqatës për kontrata të caktuara, i referohen, sipas rastit, metodës korresponduese të përshkruar në udhëzimet për prokurimin ose në udhëzimet për konsulentët.

B) Metoda specifike për prokurimin e mallrave dhe punimeve

1. Tender i Hapur Ndërkombëtar. Nëse nuk parashikohet ndryshe në paragrafin 2 më poshtë, mallrat dhe punimet do të prokurohen me kontrata të lidhura mbi bazën e Tenderit të Hapur Ndërkombëtar.

2. Metoda të tjera për prokurimin e mallrave dhe punimeve. Tabela e mëposhtme specifikon metodat e prokurimit, të ndryshme nga Tenderi i Hapur Ndërkombëtar, të cilat mund të përdoren për mallra dhe punime. Plani i prokurimeve do të specifikojë rrethanat në të cilat mund të përdoren këto metoda:

Metoda e prokurimit
a) Tender i Hapur Kombëtar – sipas modifikimeve të përshkruara në paragrafin 3 më poshtë
b) Blerje
c) Kontraktim i drejtpërdrejtë

3. Procedurat për Tenderin e Hapur Kombëtar do të bazohen në procedurat për Tenderin e Hapur, që janë përcaktuar në ligjin shqiptar për prokurimet publike, si dhe në dispozitat e mëposhtme shtesë:

i) procedurat për "Tender të Hapur", siç janë përcaktuar në ligjin shqiptar për prokurimin publik, do të zbatohen për të gjitha kontratat;

ii) pjesëmarrësit e huaj në tender nuk do të përjashtohen nga pjesëmarrja dhe në procesin e tenderimit asnjë preferencë e asnjë lloji nuk do t'i jepet pjesëmarrësve kombëtarë në tender. Ndërmarrjet shtetërore në Shqipëri do të lejohen të marrin pjesë në tender vetëm nëse ato janë ligjërisht dhe financiarisht autonome dhe operojnë sipas ligjit tregtar të Huamarrësit;

iii) entet prokuruese do të përdorin dokumente tenderimi tip, të miratuara nga Shoqata;

iv) në rast se do të ketë çmime më të larta të ofertës, të krahasuara këto me përllogaritjet zyrtare, të gjitha ofertat nuk do të refuzohen pa miratimin e mëparshëm të Shoqatës;

v) për dorëzimin e ofertave do të përdoret procedura e një zarfi të vetëm;

vi) postkualifikimi do të kryhet vetëm për ofertën me çmim më të ulët; asnjë ofertë nuk do të refuzohet për arsye kualifikimi në momentin e hapjes së tenderit;

vii) pjesëmarrësit në tender, të cilët kontraktohen si ndërmarrje të përbashkëta, do të kenë përgjegjësi solidare dhe individuale;

viii) kontratat do të lidhen me ofertuesin me vlerën më të ulët, që përgjigjet më shpejt dhe që është i vendosur të kualifikohet për të vepruar në përputhje me kriteret e vlerësimit të paracaktuara dhe

të bëra të njohura;

ix) negociatat pas dorëzimit të ofertës nuk do të lejohen as me ofertuesin me çmim më të ulët, as me ndonjë ofertues tjetër; si dhe

x) kontratat afatgjata (me kohëzgjatje më shumë se 18 muaj) do të përmbajnë dispozitat e duhura për rregullimet e çmimeve.

C) Mënyra të veçanta për prokurimin e shërbimeve të konsulencës

1. Përzgjedhja e bazuar mbi koston dhe cilësinë. Me përjashtim të rasteve kur specifikohet ndryshe në paragrafin 2 më poshtë, shërbimet e konsulencës do të prokurohen duke lidhur kontrata në bazën e përzgjedhjes bazuar mbi cilësinë dhe koston.

2. Metoda të tjera për prokurimin e shërbimeve të konsulencës. Tabela e mëposhtme specifikon metodat e prokurimit, të ndryshme nga përzgjedhja bazuar mbi cilësinë dhe koston, e cila mund të përdoret për shërbimet e konsulencës. Plani i prokurimeve do të specifikojë rrethanat në të cilat mund të përdoren këto metoda.

Metodë prokurimi
a) Përzgjedhja e kostos më të ulët
b) Përzgjedhje bazuar mbi kualifikimin e konsulentëve
c) Konsulentë individualë
d) Përzgjedhje nga një burim i vetëm
e) Me buxhet të përcaktuar

D) Rishikimi i Bankës në lidhje me vendimet e prokurimit

1. Plani i prokurimit do të përshkruajë ato kontrata, të cilat do t'i nënshtrohen rishikimit paraprak të Shoqatës. Të gjitha kontratat e tjera do t'i nënshtrohen vlerësimit pasues nga Shoqata.

Pjesa V. Tërheqja e të ardhurave të kredisë

A) Të përgjithshme

1. Përfituesi mund të tërheqë të ardhurat nga kredia, në përputhje me dispozitat e nenit II të kushteve të përgjithshme, parashikimet e këtij seksioni dhe udhëzime të tjera që mund të nxjerrë Banka, duke e njoftuar Përfituesin në lidhje me financimin e shpenzimeve të përshtatshme, siç janë përshkruar në tabelën e paragrafit 2 më poshtë.

2. Tabela e mëposhtme specifikon kategoritë e shpenzimeve të përshtatshme, të cilat mund të financohen nga të ardhurat e kredisë (kategoria), alokimet e shumave të kredisë për secilën kategori, si dhe përqindjen e shpenzimeve që do të financohen si shpenzime të përshtatshme në secilën kategori:

Kategoria	Shuma e kredisë së alokuar (e shprehur në SDR)	Përqindja e shpenzimeve që duhen financuar
1. Shërbimet e konsulentëve	2,143,000	95%
2. Trajnime	310,000	95%
3. Mallra dhe punime	10,000	95%
4. Kosto operative shtesë	37,000	95%
Shuma totale	2,500,000	

B) Kushtet e tërheqjes, periudha e tërheqjes

1. Pavarësisht nga dispozitat e pjesës A të këtij seksioni, nuk do të bëhet asnjë tërheqje për pagesa të bëra para datës së kësaj Marrëveshjeje, me përjashtim të tërheqjeve për shërbimet e konsulencës për zbatimin e pjesëve A. 1 (b) dhe (c), B. 1, B. 3, dhe C. 4 të projektit, deri në një shumë totale, e cila nuk i kalon katërqind e njëzet e pesë mijë të drejta speciale tërheqjeje (SDR 425,000), që mund të bëhen për pagesa para kësaj date, por jo më vonë se data 18 prill 2006.

2. Data e mbylljes është 15 janar 2011.

PLANI KOHOR 3
PLANI KOHOR I RIPAGIMIT

Data e pagesës	Shuma principale e kredisë, e ripagueshme

	(e shprehur në përqindje)
Çdo 15 maj dhe 15 nëntor:	
Duke filluar nga data 15 nëntor 2016 deri në dhe përfshirë datën 15 maj 2026	5%

*Përqindjet përfaqësojnë përqindjen e shumës principale të kredisë, e cila duhet të ripaguhet, me përjashtim të rasteve kur Shoqata specifikon ndryshe në pajtim me seksionin 3.03 (b) të kushteve të përgjithshme.

SHTOJCË

Përkufizime

1. "VKAR" nënkupton, në mënyrë përmbledhëse, një vëzhgim të kostos administrative dhe rregullatore.

2. "Kategoria" nënkupton një kategori të parashtruar në tabelën e pjesës V të planit kohor 2 të kësaj Marrëveshjeje.

3. "Njësia e politikave të konkurrencës" ose "NPK" nënkupton sektorin e përfshirë në "DMP" (përshkruar si më poshtë) të METE-s (përshkruar si më poshtë), përgjegjëse për vlerësimin e ndikimit të rregullave për konkurrencën e tregut.

4. "Udhëzimet për konsulencën" nënkuptojnë "Udhëzimet: Përzgjedhjen dhe punësimin e konsulentëve nga Huamarrësit e Bankës Botërore", publikuar nga Banka në maj 2004.

5. "DPA" nënkupton Drejtorinë e Përfituesit për Akreditimin, krijuar me ligjin nr.9024 "Për akreditimin e laboratorëve testues, kalibrues, organizmave certifikues dhe inspektues në Republikën e Shqipërisë" më 6 mars 2003.

6. "DMP" nënkupton Departamentin e Politikave të Tregut, përfshirë brenda Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe përfshin çdo pasues të saj.

7. "DPS" ose " Drejtoria e Përgjithshme e Standardizimit" nënkupton Drejtorinë e Përgjithshme të Standardizimit, të krijuar me ligjin nr.8464 "Mbi standardizimin" të datës 11 mars 1999.

8. "Plani i menaxhimit mjedisor" nënkupton planin e miratuar nga Përfituesi në datën 31 mars 2006, i pranueshëm nga Organizata, i cili konsiston në një sërë masash lehtësuese, monitorimesh dhe institucionale, në mënyrë që të eliminohen ndikimet mjedisore dhe sociale të pafavorshme, kompensimi i tyre ose të sigurohet reduktimi i tyre në nivele të pranueshme, si dhe veprime që nevojiten të merren për të vënë në zbatim këto masa.

9. "DPMK" nënkupton Drejtorinë e Përgjithshme për Metrologjinë dhe Kalibrimin të Përfituesit, themeluar/krijuar me ligjin nr.8996 "Mbi njësitë e matjes dhe kontrollit të instrumenteve matëse" të datës 30 janar 2003.

10. "Kushte të përgjithshme" nënkuptojnë "Kushtet e përgjithshme për kredi dhe grante të Organizatës Ndërkombëtare për Zhvillim" të datës 1 korrik 2005.

11. "Kosto operative shtesë" nënkupton shpenzime të arsyeshme dhe të nevojshme shtesë, të miratuara nga Shoqata në bazë të buxheteve vjetore të pranuara këto nga Shoqata, të kryera prej DMP-së për llogari të zbatimit të projektit, menaxhimit dhe monitorimit, duke përfshirë kostot e komunikimit, kostot e postës dhe korrierit, kostot e përkthimit me gojë dhe me shkrim, komisionet për transaksionet bankare dhe kosto të tjera, të cilat përfshihen në zbatimin e aktiviteteve të projektit, siç mund të jetë rënë dakord me Shoqatën, por duke përjashtuar pagat ose honorarët e nëpunësve zyrtarë dhe punonjësve të Huamarrësit, duke përfshirë entet e DMP-së dhe entet e përfituesit të projektit.

12. "Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikes" ose "METE" nënkupton Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës të Përfituesit dhe përfshin çdo pasues të saj.

13. "MSTQ" nënkupton metrologjinë, standardet, testimin dhe cilësinë, duke përfshirë akreditimin dhe vlerësimin për përputhshmërinë.

14. "Institucionet e MSTQ-së", ashtu siç janë përshkruar edhe këto terma këtu e më poshtë, nënkuptojnë Drejtorinë e Përgjithshme të Metrologjisë dhe Kalibrimit të Përfituesit, DPS-në dhe Drejtorinë e Akreditimit.

15. "Udhëzime për prokurimin" nënkuptojnë "Udhëzimet për prokurim në lidhje me huatë e BNRZH dhe kreditë e ONZH", botuar nga Banka në maj 2004.

16. “Plani i prokurimit” nënkupton planin e prokurimeve të Përfituesit për projektin, të datës 15 prill 2006, i cili është përmendur në paragrafin 1.16 të udhëzimeve për prokurime dhe në paragrafin 1.24 të udhëzimeve për konsulentët, e cila do të përditësohet herë pas here, në përputhje me parashikimet e paragrafëve të sipërpërmendur.

17. “Entet e Përfituesit të projektit” nënkuptojnë, në mënyrë përmbledhëse, ashtu siç janë përcaktuar edhe disa terma këtu e më poshtë, DPMK-në, DPA-në, DPS-në, dhe CPU-në.

18. “Trajnimet” nënkuptojnë aktivitetet e trajnimit (të ndryshme nga shërbimet e konsulentëve), të cilat do të zbatohen në projekt, siç janë miratuar nga Shoqata, mbi bazën e një trajnimi vjetor dhe planet për vizita studimore të pranuara nga Shoqata, duke përfshirë shpenzime të arsyeshme dhe të nevojshme për udhëtime lokale dhe ndërkombëtare dhe shpenzime për pajisjen me viza për pjesëmarrësit në seminaret e trajnimit dhe udhëtime studimore, si dhe shpenzime për akomodimin, ushqimin, shpenzime për dieta lokale dhe ndërkombëtare, shpenzime për regjistrimin, pagesat për shkollimin dhe mjetet, shpenzime të vogla organizative (duke përfshirë kostot për kancelaritë, broshurat, materialet e trajnimit), kostot e përkthimit me gojë dhe me shkrim, kostot e marrjes me qira të ambienteve dhe shpenzime të tjera të bëra direkt dhe që lidhen me seminaret e trajnimit, si dhe aktivitetin e vizitës studimore, ashtu siç mund të jetë rënë dakord me Shoqatën.

Abonimet vjetore mund të bëhen pranë Postës Shqiptare
ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi "Zhan d'Ark",
prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", nr.tel: 04 267 468
Çmimi i abonimit për Fletoret Zyrtare 2006 është 16 000 lekë.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

1. **KUSHTETUTA E SHQIPËRISË**
2. **KODET E LEGJISLACIONIT SHQIPTAR**
3. **REGJISTRAT E NOTERISË**
4. **PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI:**

1.	**PËR PROKURIMIN PUBLIK (2006)…….....**	**1500**
2.	**PËR NËPUNËSIN CIVIL (2005) …….....**	**600**
3.	**PËR SISTEMIN E DREJTËSISË (Vëllimi i I-rë dhe vëllimi i II-të-2006).....**	**1300**
4.	**PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI NË FUSHËN E ARSIMIT…….....**	**500**

Botime të reja

1	**TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT-2004 (Vëllimi I)…....….....**	**1000**
2	**TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT-2006 (Vëllimi II)…....….....**	**500**
3	**TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT-2004 (Vëllimi I)……..….....**	**1000**
4	**TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT-2006 (Vëllimi II)……..….....**	**500**
5	**PËRMBLEDHJE MARRËVESHJESH NDËRKOMBËTARE NË FUSHËN E DREJTËSISË…….....**	**1000**
6	**PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR PUSHTETIN VENDOR……**	**800**
7	**PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR NDËRTIMET…….....….....**	**500**
8	**PËRMBLEDHJE VENDIMESH UNIFIKUESE TË GJYKATËS SË LARTË (2000-2006)……**	**1000**
9	**PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR SHOQËRITË TREGTARE…….....**	**500**

Hyri në shtyp më 21.2.2007
Doli nga shtypi më 23.2.2007

Tirazhi: 3500 copë	Formati: 60x88/8

Shtypshkronja "Grafon"
Tiranë, 2007

Çmimi 16 lekë